

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË TREGTARE
“AKD Solutions” SH.P.K
ME SELI NË TIRANË

Sot, më datë 12/09/2019, i nënshkruari: Dionis Zhurda, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/04/1992, lindur në Polican, Skrapar dhe banues në Tiranë në adresën Rr.Bajram Curri, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 030514401

Vendosi:

Themelimin e shoqërisë tregtare “AKD Solutions ” Sh.P.K, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Shoqerinë Tregtare “AKD Solutions” SH.P.K, është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 2

Emri i shoqërisë


Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “AKD Solutions” SH.P.K

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë kryerja e çdo aktiviteti tregtar te lejuar nga ligji dhe/ose pjesëmarrja ne çdo veprimtari apo aktivitet te ligjshëm qe mund te kryeje një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, siç mund te ndryshohet here pas here dhe ne veçanti, por pa u kufizuar në;

Shoqëria operon në fushën e turizmit, hotelerisë, shitje / blerje biletash avioni, trageti, autobusi dhe/apo të mjeteve të ndryshme të organizimit e formave të udhëtimeve turistike, udhëtime pune, shitje / blerje te paketave turistike.



Udhëtime Turistike me grupe të organizuara brenda dhe jashtë vendit, makina me qera, siguracion shëndeti në udhëtim.

Shoqëria bashkëpunon me agjenci të tjera turistike, udhëtimi, shoqëri transportesh vendase dhe / apo të huaja, hotele, resorte, restorante, individë, familje , që kanë objekt veprimtarie të njëjtë me të apo që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë.

Shoqëria do të kryeje aktivitet në fushën e promovimit të turizmit vendas e të huaj, bashkëpunim me agjenci, përsone juridike, fizikë, individë, Institucionale të ndryshme shtetërore / publike / private, etj.

Shoqëria organizon ture të ndryshme të përmasave të ndryshme në pjesëmarrje, objektiv udhëtimi, qëllime udhëtimi, etj., të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me legjislacionin e RSH dhe atë ndërkombëtar.

Programim, menaxhim i bazave të të dhënave informatike të klientëve për arsyet promocionale.

Këshillim të klientëve për cështje marketingu, promovime online, marrëdhënie me publikun.

Shitje dhe blerje reklamore për nevojat e klientëve të shoqërisë ose të vetë shoqërisë. Këshillim, studim, programatizim dhe menaxhim i fushatave reklamore në search engine.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në: Rruga Bajram Curri, Pallati Fratari, Kat.4, Apart. nr.21

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga kontributi i ortakut themelues të kësaj Shoqërie, në para, në vlerën prej 100 (Njeqind) lek.

Kapitali themeltar i shoqërisë zotërohet nga Dionis Zhurda, i cili në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100% të vlerës së kapitalit themeltar të përbërë nga një kuotë me vlerë 100 (Njëqind) lek.



Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total. Pagesa e kapitalit themeltar kryhet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër nga Ortaku themelues.

Në rast ndryshimi te Asamblesë së Ortakëve dhe kapitalit i shoqërisë do të zotërohet nga më shumë se një përson, kuotat e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon pas regjistrimit të Shoqërisë në Registrin Tregtar dhe mund të zgjatet ose shkurtohet, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve/ortakut të vetëm.

NENI 7

Organet Drejtuese

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët zgjidhen për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë do të jetë **Dionis Zhurda**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 20/04/1992, lindur në Polican, Skrapar dhe banues në Tiranë, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me numër 03051440.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi

Dispozitat përfundimtare

Akti i Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe është në përputhje me vullnetin e lirë të themeluesit, i cili, nëpërmjet përfaqësuesve të tij e nënshkruan pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES

DIONIS ZHURDA
